

**FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVA**



PROPOZICIONET E GARAVE

Për Ligat e U-15, U-13, U-11 dhe U-9

Kampionati i Kosovës në Futboll 2017-2018

Gusht 2017

Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit, bazuar në nenin 33 p. 3 nën a), te Statutit të FFK-së, me datë 02.08.2017 aprovoi:

PROPOZICIONET E GARAVE Për Ligat e U-15, U-13, U-11 dhe U-9

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këto Propozicione, caktohet mënyra, organizimi dhe udhëheqja e garave të kampionatit të futbollit në Kosovë për rangjet garuese për U-15, U-13, U-11 dhe U-9.

Neni 2

Me garat e futbollit në rangjet e kategorive të përmendura në Nenin 1, udhëheqin Komesari i Garave, i Lidhjes Rajonale, të cilin e emëron dhe shkarkon Bordi përkatës i LRF-vë..

Neni 3

Garat kampionale të futbollit, për U-15, U-13, U-11 dhe U-9, do të zhvillohen sipas sistemit të Ligave, në të cilin do të marrin pjesë:

- **Në Ligën e U-15, garojnë deri 16 ekipe**
- **Në ligen e U-13, garojnë deri 16 ekipe**
- **Në ligen e U-11, garojnë deri 16 ekipe**
- **Në ligen e U-9, garojnë deri 16 ekipe**

Neni 4

Ekipe të U-15, garat për ndeshjet kampionale në L.Rajonale i zhvillojnë në dy rangje, në: grupin A deri 16 ekipe dhe në grupin B deri 16 ekipe.

Ekipe të U-13, garat për ndeshjet kampionale në L.Rajonale i zhvillojnë në dy rangje, në: grupin A deri 16 ekipe dhe në grupin B deri 16 ekipe.

Ekipe të U-11, garat për ndeshjet kampionale në L.Rajonale i zhvillojnë në dy rangje, në: grupin A deri 16 ekipe dhe në grupin B deri 16 ekipe.

Ekipe të U-9, garat për ndeshjet kampionale në L.Rajonale i zhvillojnë në dy rangje, në: grupin A deri 16 ekipe dhe në grupin B deri 16 ekipe.

Komisari i garave, vendosë për rastet në të cilat ekipe të përkatëse tërhiqen gjatë zhvillimit të garave por atë i nënshtrohen sanksioneve që rrjedhin nga Rregullorja Disciplinore.

Garat e grupmoshave të reja janë plotësisht të pavarura nga garat e seniorëve dhe zhvillohen sipas kalendarit të posaçëm të përcaktuar me short.

Ekipe të kampion të secilës grupmoshe nga Lidhjet Rajonale, do të zhvillojnë garën mes vete në formën e turneut ku fituesi i secilës grupmoshe do të shpallet kampion.

Turnet do të mbahen në çdo vit me rotacion në secilën Lidhje Rajonale.

Neni 5

Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, i emëron Komisarit të përkatës të Garave, në çdo Lidhje Rajonale, të cilët do të udhëheqin me gara .

Neni 6

Garat e futbollit të Kosovës zhvillohen me sistem të dyfishtë (vajtje - ardhje) sipas kalendarit të garave, të verifikuar nga Komiteti Ekzekutiv i FFK-së. Të gjitha ndeshjet zhvillohen sipas Rregullave ndërkombëtare të lojës së futbollit për çdo grupmoshë.

Neni 7

Ndeshja zhvillohet në fushën të cilën e përcakton ekipi nikoqir para fillimit të Kampionatit e cila duhet të jetë e pranuar për atë rang të garave nga komisioni për pranimin e fushave. Me kërkesë të posaçme të cilën duhet t'a aprovoj Komisioni i Garave lihet mundësia e ndryshimit të vendit (fushës) për atë ekip i cili nuk ka mundësi t'a zhvillojë ndeshjen në fushën e vet. Por, ai ekip është i obliguar ta përgatitë fushën për lojë dhe të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për organizimin dhe sigurimin e ndeshjes.

Ekipi i cili nuk e përgatitë fushën për zhvillimin e ndeshjes (pastrimin nga të reshurat atmosferike, vizatimin me vija të dukshme etj., të njëjtën e humb me rezultat zyrtar.

II.ORARI I GARAVE

Neni 8

Orarin e ndeshjeve fillimin dhe perfundimin e garave per grupmoshat e reja qe garojne ne L.Rajonale, e përcakton Komisioni i Garave ne nivelin nacional, më së voni 15 ditë para fillimit të garave (stinorit vjeshtor dhe pranveror), duke pasur parasysh kalendarin e garave të FFK-së, të cilin e miraton KE i FFK-së.

Orari i ndeshjeve përcaktohet me short,nga Komisari i Garave te lidhjeve rajonale në prezencën e përfaqësuesve të klubeve, dhe duhet të bëhet së paku 15 ditë para fillimit të kampionatit.

Gjatë tërheqjes së numrave për short, klubet që shfrytëzojnë të njëjtën fushë për ndeshje, apo që janë të të njëjtit qytet, dhe luajnë në të njëjtin rang garash, mund të kërkojnë shortin e dirigjuar, të cilin duhet t'a aprovojë Komisioni, në mënyrë që të evitohet ndeshja e dy ekipeve që përdorin fushën e njëjtë në të njëjtën ditë.

Neni 9

Garat e U-15 ,U-13, U-11 dhe U-9, janë plotësisht të pavarura nga garat e seniorëve dhe zhvillohen sipas kalendarit të posaçëm të përcaktuar me short.

- Garat e U-15, i zhvillojne dy here nga 35 min secila pjese, me 15 min pushim,
- Garat e U-13, i zhvillojne dy here nga 30 min secila pjese,me 15 min pushim,
- Garat e U-11, i zhvillojne dy here nga 25 min secila pjese, me 10 min pushim,
- Garat e U-9, i zhvillojne dy here nga 20 min secila pjese, me 10 min pushim.

Ekipe të ndeshjet do t'i zhvillohen në fushën ku i zhvillohen ndeshjet e ekipit të seniorëve, e në raste të caktuara në fushë alternative por e cila duhet të pranohet nga Komisioni për inspektim të fushave dhe të aprovet nga Komisioni që udhëheq me gara.

Neni 10

Ndeshjet kampionale zhvillohen të shtunave, të dielave apo edhe ndonjë ditë tjetër nëse për këtë vendos komisioni i Garave.

Marrëveshjet e këtilla, nuk do të pranohen për ndeshjet e dy xhirove të fundit të garave kampionale.

Neni 11

Komisari i garave në lidhjet rajonale, mund të vendos që ndeshjet e dy xhirove të fundit të kampionatit, të zhvillohen në të njejtën ditë dhe në të njejtën kohë.

Neni 12

Dimensionet e fushës për U-15 dhe U-13 duhet të jenë: min 90m x 60m. dhe Max 120m x 80m.

Dimensionet e fushës për U-11 dhe U-9 duhet të jenë: min 40m x 25m dhe max 60m x 35 m.

Neni 13

Në ekipin e U-15 (mosha 13 - 15 vjeç) të drejtë paraqitjeje, në edicionin e garave 2017-2018 kanë lojtaret që kanë lindur me 01.01.2003 e me të rinje. Me të rinjet se 13 vjeç mund të aktivizohen me kontrollim special mjekësor i cili është i vërtetuar -vulosur në Lidhjet Rajonale- FFK.

Në ekipin e U-13 (mosha 11 - 13 vjeç) të drejtë paraqitjeje, në edicionin e garave 2017-2018 kanë lojtaret që kanë lindur me 01.01.2005 e me të rinje. Me të rinjet se 11 vjeç mund të aktivizohen me kontrollim special mjekësor i cili është i vërtetuar -vulosur në Lidhjet Rajonale- FFK.

Në ekipin e U-11 (mosha 9 - 11 vjeç) të drejtë paraqitjeje, në edicionin e garave 2017-2018 kanë lojtaret që kanë lindur me 01.01.2007 e me të rinje. Me të rinjet se 9 vjeç mund të aktivizohen me kontrollim special mjekësor i cili është i vërtetuar -vulosur në Lidhjet Rajonale- FFK.

Në ekipin e U-9 (mosha 7 - 9 vjeç) të drejtë paraqitjeje, në edicionin e garave 2017-2018 kanë lojtaret që kanë lindur me 01.01.2007 e me të rinje. Me të rinjet se 7 vjeç mund të aktivizohen me kontrollim special mjekësor i cili është i vërtetuar -vulosur në Lidhjet Rajonale- FFK.

Në ndeshje mund të paraqiten vetëm lojtarët të cilët janë të evidentuar-licencuar në LRF - FFK. Identifikimin e lojtarëve e bënë **delegati** i ndeshjes, në mungesë të tij, këtë detyrë e kryen, sipas Rregullores, gjyqtari kryesor i ndeshjes dhe ate para fillimit, gjatë dhe pas ndeshjes.

Përfaqësuesit e ekipeve kanë të drejtë të vërtetojnë identitetin e lojtarëve të ekipit tjetër dhe ate para fillimit të ndeshjes. Për identifikimin e lojtarëve shërben librezat sportive e FFK-së.

Në qoftëse lojtari nuk posedon librezën sportive, identifikimi i tij bëhet në bazë të dokumentit publik (leja personale-pasaporta), e në rast të mungesës së tyre, bëhet fotografimi i lojtarit me **delegatin**. Fotografinë e siguron ai ekip, i cili në radhët e veta ka futbollistë pa librezë sportive.

Klubi është i obliguar që brenda 24 orëve, librezën sportive të lojtarit t'ia prezentoj Komisarit të Garave.

Neni 14

Identiteti i lojtarit dhe rezervistit të cilët janë shënuar në protokol, e nuk kanë mbërri deri në fillim të ndeshjes, do të vërtetohet gjatë pushimit të mespjesëve të ndeshjes apo menjëherë pas përfundimit të ndeshjes, para përpilimit të Protokolit të ndeshjes.

Përfaqësuesit zyrtar të klubeve, e kanë obligim që 45 minuta para fillimit të ndeshjes, **delegatit** të ndeshjes apo gjyqtarit kryesor (nëse mungon- **delegati**), t'ia dorëzojnë librezat sportive të lojtarëve.

Klubi nikoqir është i obliguar të siguroj ekzemplar të mjaftueshëm të protokolit si dhe kompjuterin apo makinën e shkrimit, sipas Rregullave të këtij Propozicioneve te garave.

Neni 15

I ashtuquajhuri sistem ndëshkimi „Sinbin“ aplikohet ndaj lojtarëve te cileve iu terhiqet vërejtja e fundit para ndëshkimit me kartonin e parë të verdhë, gjate zhvillimit te ndeshjes. Referi e perdor kete mase ndeshkimore- sinbin per lojtarin ne kohezgjatje deri 6 minuta pushim mvaresisht nga grupmoshat.Për grupmoshat U-9 nga 2 deri 3 min, U-11 nga 2 deri 4 min, U-13 nga 3 deri 5 minuta dhe U-15 nga 3 deri 5 minuta.

Neni 16

Ekipi i cili e fiton ndeshjen në garat kampionale inkason 3 pikë, kurse nga ndeshja rezultati i të cilës është i barabartë, secili klub inkason nga një pikë. Për secilën garë të përhershme e cila zhvillohet sipas sistemit të pikëve, përpilohet (mbahet) tabela.

Tabela përmban: emrat e ekipeve, numrin e ndeshjeve të zhvilluara, rezultatet e arritura në këto ndeshje, numrin e pikëve të fituara dhe numrin e golave të shënuara respektivisht të pranura (pësuara).

Plasmani i ekipeve në tabelë caktohet në bazë të pikëve të fituara. Në rast të pikeve të barabarta aplikohet Rregullorja e Garave e FFK-se dhe propozicionet e garave të U-17 dhe U-19.

GARAT E KUP-ës

Neni 17

Garat e KUP-ës së Kosovës, për grupmoshat e reja, mund të zhvillohen me vendimin e Bordit të LRF-ve.

Mënyra e garimit dhe kriteret tjera përcaktohen nga Bordi i LRF-ve por gjithnjë duke i respektuar rregullat e lojës IFAB dhe aktet normative në fuqi. Aplikohet Rregullorja e Garave.

NUMRI MË I VOGËL I LOJTARËVE DHE ZËVENDËSIMET E TYRE

Neni 18

Ndeshja nuk mund të filloj-zhvillohet nëse njëra prej ekipeve ka më pak se 7 (shtatë) lojtarë për U-15 dhe U-13.

Lojtarët të cilët nuk e fillojnë ndeshjen, kanë mundësi të futen në lojë deri në fund të ndeshjes, dhe atë në mënyrë të paraparë me këto Propozicione të garave, nëse para fillimit të ndeshjes janë shënuar në protokolin e ndeshjes si lojtarë apo rezervistë.

Neni 19

Ndeshja nuk mund të zhvillohet nëse njëra prej ekipeve ka më pak se 2 lojtare për grupmoshat U-11 dhe U-9.

Neni 20

Në ndeshjet kampionale dhe për KUP, gjatë lojës për keto grupmosha mund të ndërrohen nga 5 (pese) lojtare në secilin ekip, duke respektuar dispozitat e FIFA-së për grupmosha të reja.

Zëvendësimet mund të kryhen vetëm me lojtarë të cilët para ndeshjes janë evidentuar në Protokolin e ndeshjes.

XVIII. KONTROLLIMI MJEKËSOR I LOJTARËVE

Neni 21

Secili lojtar në librezën e vetë sportive, duhet të ketë të shënuar kontrollimin mjekësor të kryer. Afati i vlefshmërisë së kontrollit mjekësor për lojtarë zgjatë 6 (gjashtë) muaj.

Libreza e lojtareve duhet medoemos ta ketë vulën me të cilën shifet se lojtari e ka kaluar testin mjekësor (në të kundërtën nuk ka të drejtën e lojës).

Klubet janë të obliguara t'i përmbahen në tërësi Rregullores së garave të FFK-së, sa i përket kontrollimit mjekësor dhe personelit mjekësor.

AFATI KALIMTAR I LOJTARËVE

Neni 22

Afati kalimtar i lojtarëve të cilët dëshirojnë të kalojnë nga një klub në klubin tjetër të Kosovës, është i përcaktuar nga KE i FFK-së.

Për garat e grupmoshave të reja të organizuara nga LRF-të, afatet mund të përcaktohen nga Bordet e tyre me kusht që të njohtohet FFK për të pasur sistem dhe standarde të njëjta në gara dhe afate kalimtare.

Aplikohet rregullorja mbi statusin, regjistrimin dhe transferin e lojtareve të FFK-së.

XXV. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 23

Çdo vendim që merret në përputhje me këto Propozicione të Garave, është obligativ për të gjithë, derisa dispozitat e këtyre Propozicioneve të mos ndryshojnë.

Ndryshimet dhe plotësimet e këtyre Propozicioneve i bënë Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, në procedurën e njejtë si për aprovimin e tyre.

Neni 24

Për çështjet që nuk janë përfshirë në këto Propozicione, vlenë Rregullorja e Garave.

Rregullorja Disciplinore, aktet tjera normative të FFK-së, si dhe Rregulloret e lojës së futbollit, të UEFA-së.

Neni 25

Këto Propozicione u miratuan me 2 Gusht 2017.

Propozicionet e Garave hyjnë në fuqi ditën e ardhshme pas nënshkrimit të saj.

Prishtinë, 2 Gusht 2017

Kryetari i FFK-së,
Fadil Vokrri

Sekretari i Përgjithshëm,
Eroll Salihu